



VENDIM

Nr. 27, Datë 15.02.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
E PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 16 pika 7, dhe 47 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” si dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.02.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike për fillimin e procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore” (RCP),

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore” (RCP).
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI